



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-#:	Numër: 02-10/22
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	27.09.2022
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL:

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së dhjetë (10) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 27.09.2022, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshtëndeti Kryetarin e Komunës z. Ruzhdi Shehun, nënkyetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtoret e drejtive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit. Në mbledhje nga drejtoret prezent ishin: znj. Leunora Shehu-AD, znj. Vjollca Qestaj-DBF, znj. Gentiana Tofaj-DZHE, z. Zenun Shala-DUKM, z. Xhavit Velijaj, z. Fatos Shala-DSHMS, z. Demokrat Ganijaj-DSHPMS.

Anëtarët prezent

- | | |
|--------------------------------------|-------------------------------------|
| 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK | 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtar, AAK |
| 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK | 11. Erleta Qestaj - Anëtar, AAK |
| 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK | 12. Festina Maloku - Anëtar, AAK |
| 4. Albertina Gacaferi - Anëtar, LDK | 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV |
| 5. Ermelinda Llolluni - Anëtar, LDK | 14. Eliza Pepshi-Anëtar, LVV |
| 6. Lirjeta Shehu - Anëtar, LDK | 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |
| 7. Leonard Llolluni - Anëtar, AAK | |
| 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK | |
| 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK | |

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
2. Formim i Grupit të punës për hartimin e projekt Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2023,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për Tatimin në Pronën e paluajtshme për vitin 2023,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2023,
6. Bartja dhe rritja e të hyrave vetanake,
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së Drejtorisë për Kadastër dhe Mjedis për përmirësimin teknik të emrave të rrugëve,
8. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,

z.Lulzim Gacaferi, përshëndetje për të gjithë, unë kërkoj nga procesmbajtësi që të ketë më shumë parasysh drejtshkrimin.

z.Shpejtim Gacaferi, tjetër vërejtje nuk ka, i qes ne votim dy procesverbalet nga mbledhjet e kaluara, kush është për, për? 15 vota për, kundër 0 vota, abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e kaluara miratohen.

2. Formim i Grupit të punës për hartimin e projekt Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2023,

Shpjegimin dhe arsyetimin e Formimit te Grupit të punës për hartimin e projekt Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2023, para anëtarëve te Kuvendit e arsyetoje Kryesuesi i Kuvendt, z. Shpejtim Gacaferi, i cili sqaroj se pjese e këtij grupi nga viti i kalura ishin: 1. z.Shpejtim Gacaferi-LDK, 2. znj.Albertina Gacaferi-LDK, 3. znj. Erleta Qestaj-AAK 4. znj.Eliza Pepshi-LVV 5. znj. Leonora Shehu-Ekzekutivi, po pres propozime te reja.

z.Sadri Krasniqi, përshëndetje për të gjithë, ne si grup propozojmë te njëjtit anëtar të vitit te kaluar.

z.Leonard Llolluni, përshëndetje për të gjithë, edhe grupi i AAK-se propozon te njëjtën anëtar znj.Erleta Qestaj.

z.Lulzim Gacaferi, edhe nga grupi i LVV-je, mbete propozimi i njëjtë znj.Eliza Pepshi.

z.Shpejtim Gacaferi, atëherë edhe nga Ekzekutivi mbetet e njëjta anëtar znj. Leonora Shehu, e qes në votim, kush është për ketë përbërje? për 15 vota, kundër 0 vota, abstenim 0 vota, konstatoi se grupi i punës për hartimin e projekt planit t punës së kuvendit të komunës së Junikut për vitin 2023 u miratua.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023,

Shpjegimin dhe arsyetimin e miratimi te projekt Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023, e beri Kryetari i Komunës z.Ruzhdi Shehu, i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë te pranishmit me pas e sqaroi dhe e arsyetojë projekt buxhetin e Komunës se Junikut për vitin 2023 para anëtarëve te Kuvendit.

z.Sadri Krasniqi, ne sote po e diskutojmë kornizën buxhetore për vitin 2023, siç e dimë është dokumenti me i rendesishem i komunes, i cili tregon qasjen dhe zhvillimin ekonomik te komunes, nga kryetari komunes dhe ekzekutivi, ne si grupi i LDK_së e kemi analizuar ketë buxhete dhe mendojem se i planifikuar dhe i ndërtuar shume mire, shihet se ka ngrite buxhetore nga buxhetet e me parshme, kjo eshte per tu lavdruar, dhe ne mendojmë se ku buxhete shkon sa me afer qytetarit, si ne buqesi. Si grupi e përkrahim dhe do ta votojmë.

z.Leonard Llolluni, sa i perkete kronizet afatmesme buxhetore 2023-2025, sipas meje dhe sipas grupit te AAK_së mendoje se komuna e Junikut nuk ka patur asnjë here planifikim buxhetor kaq racional, ku një komunë e vogel si komuna e Junikut ndan për mallra dhe shërbime 236000€, ndërsa planifikon shpenzime kapitale 380000€, sa i përket shpenzimeve kapitale, nuk ka ndonjë projekt që është racional për qytetarët e komunës se Junikut, që ka qenë edhe premtim i Kryetarit të Komunës, as një premtim te kryetarit nuk e keni futur në buxhet për vitin 2023, u përmend se ka patur rritje te buxhetit, unë e shtroj pyetjen se për se nuk keni planifikuar rritje të te hyrave edhe për 2023 por e keni lenë ashtu 159000 prape per te hyra vetanake. Te projektet kapitale kemi te ndara 20000€ për blerjen e veturës, dhjetë vutura keni ne oborr, para dy viteve kemi blerë një veturë të re dhe prap parashikoni që për vitin e ardhshëm ta bleni një veturë 20000€, e për projekte kapitale keni ndarë 10000€ për hapjen e rrugëve në fshatin Gjocaj, në vend që ta funksionalizoni rëntgenin që është edhe premtim i kryetarit ju doni te bleni veturë të re 20000€, premtim tjetër është edhe rregullimi i shiheshit te qendrës se Junikut, këtu e keni cekur rregullimin e shehit te qendrës e aty shihet se nuk dihet burimi i financimit, ndërsa me vonë si dokument na vije përmes e-mailit, lista e projekteve dhe ne atë listë nuk është i përfshirë ky projekt dhe ne tani nuk dimë se cilat projekte janë dhe cilat nuk janë, dy projekte janë në drejtorinë shërbimeve publike, njëri është rregullimi i rrugëve lokale ndërsa tjetri është ne mallra dhe sherbime prap thotë infrastruktura rrugore kjo është e pa çartë, ne si grup i AAK_se nuk do ta perkrahim ketë projekt buxhet.

z.Lulzim Gacaferi, sa i përket projekt buxhetit për vitin 2023, do ishte shumë më mirë qe kryetari i komunës të ulet me ne si LVV para se ta bente ketë projekt, ne kemi një marrëveshje LDK-LVV, ku unë personalisht ndihem krenar qe kemi atë marrëveshje, ku me anën e asaj marrëveshje kanë ardhur ndryshimet ne Komunën e Junikut, unë do doja qe sot ta votoja ketë projekt buxhet me grupin e LVV_mirëpo duke e marrur parasysh qe ne kishim një marrëveshje e që në atë marrëveshje është e cekur që projekt që unë e kisha berë me LVV_je për komunën e Junikut për vitin 2021 dhe ai projekt nuk ekziston me është shuajtur, na është thënë se nuk mundemi ta realizojmë ketë projekt sepse preken jo prona private, jo prona publike, por mbi te

gjithë shtetë injorimi që na është berë si LVV_je, nuk jemi stuar asnjëherë për ketë projekt buxhet ta planifikojmë bashkërisht siç kishim një marrëveshje andaj ne si LVV_ për fat të keq nuk do ta votojmë ketë projekt buxhet.

z.Ruzhdi Shehu, te mallrat dhe shërbimet hynë edhe mirëmbajtja e rrugëve gjatë dimrit, furnizimi me dru për djegie për shkollat janë çështje që e kanë ngritur ketë kategori sepse nuk janë çmimet që ishin ka ngritje, çështja tjetër e veturës, te them te drejtën aspak me dëshirë nuk e kemi futur në ketë projekt buxhet, por arsyja është se asnjë veturë nuk është funksionale, tri here kemi hapur tender për mirëmbajtjen e tyre dhe nuk ka aplikuar askush, dhe ne kemi menduar që një veturë po na nevojitet që drejtorët dhe zyrtarët të udhëtojnë me te për në Prishtinë sipas nevojave te drejtorëve dhe zyrtarëve, është e domosdoshme që të kemi mundësi te funksionojmë si komune jo për lloks, ndërsa sa i përket çështjes se rregullimit te sheshit qendër te Junikut ne e kemi futur si projekt, por se pari duhet ekspertët ta jasin mendimin e vet dhe me pas të flasim me grupet e interesit me qytetarët e me pas ta kemi një projekt të detajuar kështu shkohet kjo, ne e kemi paraparë ne kornizën buxhetore për vitin 2024, 2025.

z.Lulzim Gacaferi, projekt është por ju na keni injoruar neve si LVV_je.

z.Zenel Maloku, pëershendetje për të gjithë, u fol për veturë, unë e di se këmbë nuk udhëtoni por unë propozoi qe ti shitni tri vetura të vjetra dhe ta bëni një, dhe tjetër është që do ishte mirë që të diskutoni me te gjithë këtu ne kuvend se votat e te gjithë Junikut janë këtu, do ishte shumë me mirë të bisedohet edhe me delegatët e këtij kuvendi dhe sipas mendimit tim shumë më mirë do ishte dalë ky projekt buxhet.

z. Shpejtim Gacaferi, ne kemi mbajtur dëgjime publike kush ka dashur te vijë ka ardhur kush nuk ka dashur mos me ardhë nuk ka ardhur, dhe asnjë here me parë si ketë vit nuk kanë mbajtur dëgjime publike. Si për ketë projekt buxhet propozime tjera nuk ka, e qes në votim projekt buxhetin për vitin 2023 kush është përfunduar? përfunduar 6 vota. Kundër 8 vota, abstenim 1 votë, konstatoi se projekt buxheti përfunduar 2023 nuk miratohet.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores përfundim të pronë e paluajtshme përfundim 2023,

Shpjegimin dhe arsyetimin e miratimi i plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores përfundim të pronë e paluajtshme përfundim 2023, e beri Drejtoresha e Buxhetit znj. Vjollca Qestaj, e cila fillimisht i përshëndeti te gjithë dhe me pas e sqaroi dhe e arsyetoj para anëtarëve të Kuvendit plotësim ndryshimin e projekt rregullores përfundim të pronë.

z. Shpejtim Gacaferi, propozime nuk ka, e qes ne votim plotësim-ndryshimin e rregullores përfundim ne pronë e paluajtshme përfundim 2023 kush është përfunduar? përfunduar 15 vota, kundër 0 vota abstenim 0 vota konstatoi se plotësim ndryshimin i rregullores se tatimit ne pronë e paluajtshme përfundim 2023 u miratua.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës përfundim e procedurave përfundim-ndryshim të Rregullores përfundim taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale përfundim 2023,

Shpjegimin dhe arsyetimin e miratimi i kërkesës për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2023, e beri Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik, znj. Gentiana Tofaj e cila fillmisht i përshëndeti te gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoi para anëtarëve të kuvendit kërkesën për fillimin e proceduarve për plotësim-ndryshim te rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2023.

z.Leonard Llolluni, faleminderit Kryesues, faleminderit Drejtoreshë, është mirë që kemi ketë kërkesë për fillimin e proceduarve për plotësim-ndryshim te rregullores për taksa, mbetet shqetësuese se me siguri edhe kjo qeveri do të merr rekomandim nga auditori sa i përket borgjit nga bizneset, dhe këto borgje ose duhet te inkasohen ose duhet që ky kuvend te merr një vendim që ti falë këto borgje.

z.Gentiana Tofaj, po është e vërtet se bizneset kanë shumë borgje, ne fillmisht ju kemi dërguar vendimet ne fillim te muajit Mars siç kërkohet me rregullore, një pjesë e tyre kanë paguar, tani se fundi ju kemi dërguar prap njoftimet për pagesë se nëse nuk mund ta paguajnë borgjin komplet minden te bëjnë kontratë me ne qe ti paguajnë pjesë pjesë, por nëse edhe me ketë mënyrë nuk kemi përgjigje atëherë duhet te shikohet mundësia qe o me i inkasuar përmes përbartuesit o Kuvendi te mere vendim per faljen e borgjeve.

z.Zenel Maloku, unë e di se borgji duhet te lahet, se përndryshe nëse merret tani borgj e te thuhet mbas tri viteve nuk po muj me e la borgjin kështu unë isha bere milioner.

z.Shpejt Gacaferi, propozime tjera nuk ka e qese ne votim kërkesës për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2023, kush është për? Për 15 vota, kundër 0 vota abstenim 0 vota, konstatoi se kërkesës për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2023 u miratua.

6. Bartja dhe rritja e të hyrave vetanake,

Shpjegimin dhe arsyetimin e Bartjes dhe rritja e të hyrave vetanake, para anëtarëve te Kuvendit e beri fillmishte Kryetari i Komunes z.Ruzhdi Shehu, me pas për arsyetim me te detauar fjalën ja kaloj, znj. Vjollca Qestaj e cila me pas e sqaroi dhe e arsyetoj bartjen dhe rritjen e te hyrave vetanake para anëtarëve te kuvendit.

z.Leonard Llolluni, faleminderit kryesues, faleminderit drejtoreshë, do ishte mirë qe këto sqarime qe i bere ti kishim edhe ne dokument, dhe kur te na vije dokumenti te jene te shkruar dhe kur ta votojmë ta votojmë taman dokument, te projekt 66405 planifikimi i urbanizimit për realizimin e hartimit te projektit e sheshit qendrës se Junikut, mendojë se është vonë ti bartim këto mjete për ketë vite sepse mendoj se ketë vit nuk do te fillojë te punohet diçka ne ketë drejtim.

z.Ruzhdi Shehu, ketë vit jo por vitin tjetër.

z. Leonard Llolluni, por atëherë prap duhet ti bartim këto mjete ne raste se nuk shpenzohen ketë vit, do ishte mire qe bartja e mjeteve te behet me vone dhe këto mjete dhe ato mjetet qe grumbullohen tani e tutje.

z. Arten Hamza, përshëndetje për te gjithë, sa i përket këtyre procedurave dihet se këto mjete nuk do te shpenzohen ne tersi ketë vit te gjitha, por janë te hyra vetanake dhe nuk rrezikohet humbja e tyre, mire por qe te fillohet te nënshkruhet një kontrate kërkohet qe te ketë mjete financiare te ndara për atë kategori për te filluar procedurat e prokurimit.

z. Shpejtim Gacaferi, propozime tjera nuk ka, e qes ne votim, bartja dhe rritja e të hyrave vetanake, kush është për? Për 7 vota, kundër 7 vota, abstenim 1 votë, atëherë me votën time te dy fishtë, miratohet bartja dhe rritja e të hyrave vetanake.

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së Drejtorisë për Kadastër dhe Mjedis për përmirësimin teknik të emrave të rrugëve,

Shpjegimin dhe arsyetimin e kërkesës së Drejtorisë për Kadastër dhe Mjedis për përmirësimin teknik të emrave të rrugëve, e beri Drejtori i Kadastrës, Urbanizimit dhe Mjedisit, z. Zenun Shala, i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë dhe me pas e sqaroi dhe e arsyetoi kërkesës së Drejtorisë për Kadastër dhe Mjedis për përmirësimin teknik të emrave të rrugëve, para anëtarëve te kuvendit.

z. Leonard Llolluni, faleminderit kryesues, do ishte mirë qe ti shtohet parashtesa p.sh. ne tabelë te shënohet rr. UÇK_së

z. Zenun Shala, kjo është kërkuar qe te hiqet Rruga e UÇK_së por të jetë vetëm rr. UÇK_së

z. Shpejtim Gacaferi, propozime tjera nuk ka, e qes ne votim kërkesën e Drejtorisë për Kadastër dhe Mjedis për përmirësimin teknik të emrave të rrugëve, e qes ne votim kush është për? për 15 vota, kundër 0 vota, abstenim 0 vota, konstatoi se kërkesa e DUKM për përmirësimin teknik te emrave te rrugës u miratua.

8. Të ndryshme,

z. Lulzim Gacaferi, çështja ka te beje me punimet te stacioni i autobusëve, aty nuk është duke u punuar sipas kontratës se nënshkruar ne mese Komunës se Junikut dhe operatorit andaj kërkojë qe komuna te shtoje kontroll, ne kontratë ne piken 2.1 nëse nuk gabojë, shkruan qarte se operatori ekonomik e ka për obligim qe përpos hapjeve te themeleve ka për obligim edhe 200 m² asfalt ti largoi dhe ti dërgoj ne deponi, operatori ekonomik e ka prerë asfaltin vetëm aty ku hapen themelet ndërsa pjesa tjetër e asfaltit qe lëshon edhe materie kimike te dëmshme për shëndetin e njeriut ka mbetur aty, unë kërkojë qe te me jepni sqarim a ka komuna e Junikut kontrate tjetër a ka kontrollë se si po punohet apo edhe tani po ecet me avazin e ish kryetarit Agron Kuçi?

- z. Zenun Shala, unë nuk e di se asfalti lëshon materie te dëmshme, por këto çështje qe i ngrite do i shikojmë, kemi ngritur komision për mbikëqyrjen e punëve ne ketë komision ka inxhinier te ndërtimit dhe ata na raportojnë për ecurinë e punëve.
- z. Lulzim Gacaferi, çështja tjetër ka te beje me arsimin, ne e dimë se arsimi për momentin gjendet ne bllokadë nga greva e sindikatës, unë kam biseduar me kryetarin privatisht qe ta bëjmë te mundur fillimin e mësimit për nxënësit e komunës tone, dhe mua po me intereson drejtor a keni biseduar me organet e arsimtarëve qe shkollat ne komune e Junikut tija fillojnë mësimeve.
- z. Xhavit Velijaj, përshëndetje për te gjithë, ne jemi ne dijeni qe greva është ka vazhdon, jo vetëm ne arsim por edhe ne administratë ne shumicën e vendit, neve na ka ardhur një shkresë nga arsimtaret se janë ne grevë nga data 25.08.2022, dhe kjo ka mbetur ashtu deri me tanë, ne si DKA ligjërisht nuk kemi mundësi te bëjmë presione as ne aspektin material por as ne aspektet tjera qe arsimtaret te ndryshojnë pozicionet e tyre, kjo ka mbetur qe te zgjidhet me marrëveshje ne mes qeverisë qendrore dhe sindikatave, fatkeqësisht deri me tanë nuk ka një marrëveshje.
- z. Lulzim Gacaferi, mua po me intereson se ju si drejtori çka keni bere deri tanë, ajo qe po thua ligjërisht ajo po dihet po ju si DKA çka keni vepruar, sepse ne qoftë se janë ne pyetje 50€ aty unë jam ne gjendje te jua paguaj secilit mësues ne komunën e tonë vetëm qe te mos ndëshkohen nxënësit tanë, jam ne gjendje te beje kontratë me juve qe pagesa prej 50€ te ju behet secilit mësues vetëm te nis mësimi.
- z. Xhavit Velijaj, nuk është çështja vetëm ne komunën tone por kjo çështje është ne nivel vendin, është organizim sindikal, kane vendime qe janë te njobura për gjithë ne dhe nuk varet prej DKA_së.
- z. Leonard Llolluni, faleminderit kryesues, me qen se jemi ne piken te ndryshme, unë e kam marë nga qytetaret si shqetësim furnizimin me dru qe zyra e parkut nacional nuk po lejon qytetaret qe te furnizohen me dru për dimër nga pyjet e tyre, e ku ne e dimë se ka shume pyje qe duhet te pastrohen nga drutë e thatë dhe te dëmtuara, dhe me intereson a ka bërë komuna presion qe zyra e parkut nacional te filloje te lëshojë leje për dru për djegjeje.
- z. Ruzhdi Shehu, ka një muaj apo edhe me shume qe ne ju kemi dërguar kërkesë parkut nacional dhe ende nuk kemi një konfirmim nga ana e tyre. Por ketë shqetësim e kemi diskutuar edhe ne takime qe kemi pasur ne kryetaret e komunave te regjionit te Dukagjinit me ministrinë por edhe aty nuk kemi një përgjigje, ndërsa sa i përket çështjes se fillimit te mësimit është shqetësim me te drejtë, unë kam biseduar me personat adekuat te sindikatës ne komunën e Junikut dhe si Komune nuk mundemi ti detyrojmë as te marrim masa kundër tyre, mirëpo si komune jemi te interesuar qe te krijohet klimë e mirë për fillimin e mësimit sepse është edhe interes i yni qe mësimi te filloje, shpresoje qe kjo çështje te merr fund sa ma shpejt edhe ne nivel qendoror dhe po shpresojmë qe kjo te merr fund sa ma shpejt, është çështje e ndjeshme dhe na shqetëson edhe neve.

z.Dervish Bajraktari, përshëndetje për te gjithë, unë kam disa pyetje për drejtorin e shërbimeve publike, çështjen e parë është rruga te “xhamija e qokit” e cila është ngushtuar nga therrat dhe ka vetëm një anë te kalueshme, çështja tjetër ka te beje me kanalin e ujit qe gjendet afër stacionit te autobusëve, dje ka pasur reshje te shiut dhe nga ky kanal kanë dalur mbeturina dhe ujë ne rrugë, ku qytetaret e kanë pasur te pa mundur te kalojnë do kishte qenë mirë qe te ndërmerrni diçka për këto çështje.

z.Zenel Maloku, unë e përshëndes propozimin e z. Lulzim Gacaferi i cili propozoi qe ti paguaj mësuesit e shkollave te komunën se Junikut me nga 50€ vetëm qe te filloje mësimi, e ne ketë aspekt unë i lus kryetarin e komunës dhe drejtorin e arsimit te ulen me mësuesit e shkollave dhe te gjejnë zgjidhe qe mësimi te filloj sa më shpejtë në Komunën e Junikut, çështja tjetër ka te beje me malijet e fshatrave Jasiq dhe Gjocaj qe janë mbi zonën qe kontrollohet nga komuna e Junikut, e une e kisha lutar kryetarin qe brenda mundësive te bisedoje me rojet e malit dhe me policinë qe neve qytetarve te ketyre dy fshatrave te na mundësohet ti pastrojmë malet tonë dhe te furnizohemi me dru djeg-je për dimër sa është moti i përshtatshëm, çështja tjetër është nuk e di a keni qen me e pa rrugën qe është ka ndërtohet ne rrugën Jasiq-Gjocaj aty janë vendosur disa mbrojtëse te rrugëve qe për mua shfaqin rreziqe dhe ata gurë qe janë vendosur mund te rrrokullisen te mbysin kalimtaret me automjete unë ju kisha lutar qe te merni masa qe sa ma parë, unë e di se është projekt qeveritare por aty ku puna është ka behet qe rrezikohet jeta e qytetarit komuna e ka te drejtën qe tija ndaloj punimet, ndërsa çështja tjetër ka te beje me rrugën ne lagjen e epërme te fshatit Gjocaj e cila është pa rrugë, do ishte mirë qe ketë rrugë ta futni ne projekt buxhetin për vitin e ardhëm. Çështja tjetër ka të bëjë me lirimin e trotuareve për tu mundësuar nxënësve vijimin për në shkollë dhe nënkyetari na pat premtuar se do te shikojë mundësinë te bejë sinjalizimin sa me parë.

z.Ruzhdi Shehu, sa i përket rrugës per Jasiq Gjocaj, ne e kemi ndaluar asfaltimin sepse paraqet rrezik, jemi duke shikuar mundësinë me inxhinierët se si te veprohet, ndërsa sa i përket rrugës ne lagjen e eperme ne fshatin Gjocaj ajo rrugë është ne projekt buxhet për vitin e ardhëm.

z. Demokrat Ganijaj, përshëndetje për te gjithë, ketë kërkësë për rrugën Jasiq –Gjocaj z. Zenel Maloku e ka pasur edhe me parë nuk është hera e parë qe e ngreh si çështje, por unë dua ta siguroj se ne e kemi ngritur ketë çështje dhe kemi vizituar vendin e ngjarjes s'di sa here dhe kemi thënë se kjo formë nuk është dhe e kemi ndaluar asfaltimin ne atë pjesë, ndërsa sa i përket çështjeve te z.Dervish Bajraktari ne do ti shikojmë dhe do te ndërmarrim masa.

z. Besart Tofaj, përshëndetje për te gjithë, unë kame thënë se do te behet lirimi i trotuareve me fillimin e mësimit.

z. Lulzim Gacaferi, çështja ka te beje me kompaninë për mbledhjen e mbeturinave, ne deri tash kemi pasur një kompani vendore qe ka kryer këtë shërbim e qe për mendimin tim e ka kryer shumë mirë tanë kemi një kompani tjetër te pa njojur për ne, e qe deri me tanë nuk kemi as fatura


dhe ne nuk e dimë se sa do te na kushtojë, desha te di a ka tender te hapur për këtë kompani sa do te na kushtoj muaji, dhe pse është shkëputur kontrata me kompaninë VB-Tofaj?

z. Demokrat Ganijaj, sa i përket kompanisë për mbledhjen e mbeturinave, kompania VB-Tofaj ka shkëputur një anshëm kontratën, kompania qe tani kryen ketë shërbime është kompani publike regionale, çmimi për kontejner ka me qene i njëjtë.

Mbledhja e Shtatorit -2022 u shpall e mbyllur ne ora:11:35

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha



Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

